



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

AC-I-22-0455-A0002

**Në çështjen juridike të:**

J R nga Fshati K- Komuna e Ferizajt.

**Paditësi/ankuesi**

**Kundër:**

**Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP)**, Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakrishte- Prishtinë.

**E paditura/ankuesja**

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJSK), i përbërë nga Mr. Sc. Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Ilmi Bajrami gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit dhe të paditurës, të parashtruar kundër Aktgjykimit të Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-16-0315, të datës 27 korrik 2022., pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 07 dhjetor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

1. Ankesa e paditësit është e bazuar.
2. Ndryshohet Aktgjykimi i Shkallës së parë të DHPGJSK-së C-IV.-16-0315, i datës 27 korrik 2022. Në vend të 3 pagave për shkak të ndërprerjes para kohe të marrëdhënies së punës, paditësit t'i kompensohen 6 paga nga 173,00 euro, gjithësejt 1.038,00 euro.
3. Pjesa tjetër e aktgjykimit të ankimuar mbetet i pa ndryshaur.
4. Ankesa e AKP-së refuzohet si e pa bazuar.
5. Nuk caktohen taksa gjyqësore për këtë procedurë ankimore.

### **Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Më 08 qershor 2016, paditësi kishte parashtruar ankesë në DHPGJSK kundër Vendimit të Autoritetit të Likudimit të NSH “Komogllava”, e adminstruar nga AKP (AL i AKP-së) GJII135-0012 dhe GJII135-0013, të dy këto vendime të datës 08 qershor 2016. Me Vendimin GJII135-0012 ishte refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara në shumë prej 3.2870.00 euro, për periudhën qershor 2012 e deri në muajin dhjetor 2013.

Me Vendimin GJII135-0013 ishte refuzuar kërkesa e paditësit për kompensimin për ndërprerje të parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 1,038,00 euro

Në të dyja vendimet është arsyetuar se nuk ka asnjë dëshmi që vërteton se parashtruesi kishte një marrëdhënie aktive dhe të vlefshme pune me N.SH-në për periudhën të cilën kërkohet komepnzimi i pagave, dhe se në bazë të provave të siguruara, nuk rezulton që kjo marrëdhënie e punës të jetë ndërprerë si pasojë e ndërprerje së marrëdhënies së punës nga e paditura.

Paditësi ka pohuar se pas luftës ka punuar në ishNSH-në nga data 03 janar 1990 e deri më 30 mars 2014, kur ka filluar procesi i likudimit të ndërmarrjes. Paditësi kishte propozuar që të aprovet ankesa e tij si e bazuar dhe t’i njihet e drejta në kompensim për paga të pa paguara në shumë prej 3.287.00 euro, e po ashtu t’i kompensohen edhe pagat në emër të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës në shumën prej 1.038,00 euro.

Më 26 qershor 2016, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës së paditësit theksoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit duke i konsideruar të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohen. E paditura ka pohuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 18.2 të Ligjit për AKP-në i cili parsheh se “Agjencia nuk është përgjegjëse për kurrfarë borxhi, veprimi ose mosveprimi që i atribuohet një ndërmarrje”, dhe se të njëjtës i mungon legjitimiteti real pasiv për të qenë palë në këtë çështje juridike. Paditësi, përkundër kësaj, nuk ka arritur që të dëshmoj se për periudhën kontestuese ka kryer punë aktive në ndërmarrje, andaj ka propozuar që ankesa të refuzohet si e pa bazur dhe të vërtetohet vendimi i kundërshtuar i AL të AKP-së.

Më 27 korrik 2022, Shkalla e parë e DHPGJSK-së kishte marrë Aktgjykim me të cilin ishte aprovuar si e bazuar ankesa e paditësit, ishte ndryshuar Vendimi i AL të AKP-së të AKP-së GJII135-0012 dhe Vendimi GJII135-0013 të datës 08 qershor 2016. Njëherit ishte obliguar e

paditura që paditësit, në emër të kompensimit për paga të pa paguara për periudhën qershor 2012, e deri në muajin dhjetor 2013, t'ia paguaj shumën prej 3.287.00 euro. Po ashtu t'ia kompensoj dëmshpërblimin për shkak të ndërprerjes së parakohshme të marrëdhënies së punës, 3 paga nga 173.00 euro, në shumën prej 519.00 euro, brenda afatit prej 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi, si dhe ishte detyruar e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës (takes për ankesë), palës paditëse t'ia kompensojë shumën e mjeteve në lartësinë prej 20.00 euro brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit.

Në arsyetim të vendimit thuhet se me rastin e aprovimit të ankesës sipas dispozitës të nenit 245 par.1 të LMD-së, është përcaktuar se kreditori në raporte detyrimore është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori është përgjegjës ta përmbushë detyrimin e tij në mënyrë të ndërgjegjshme. Nga provat e shqyrtuara në këtë qështje juridike gjykata ka gjetur se parashtruesi i ankesës ka qenë punëtor aktiv në ndërmarrje kjo vërtetohet nga vërtetimi i datës 13 janar 2014, i lëshuar nga drejtori i ndërmarrjes. Po ashtu duke u bazuar në listen e pagave të pa paguara të cilat janë nënshkruar nga drejtori është vërtetuar se parashtruesit të ankesës nuk i janë kompensuar pagat e kërkuara para Autoritetit të Likudimit dhe se lartësia e pages së tij ka qenë në shumë prej 173.00 euro.

Shkalla e parë duke e arsyetuar njohjen e kërkesës për paga të pa paguara, thekon se neni 245 paragrafi 1 i LMD-së kreditori në raporte detyrimore është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori është përgjegjës që ta përmbushë detyrimin e tij. Nga Vërtetimi i datës 13 janar 2014 dhe nga lista e pagave të pa paguara, të cilat janë të nënshkruara nga drejtori i NSH-së, është vërtetuar se parashtruesit të kërkesës nuk i janë kompensuar pagat e kërkuara tek AL i AKP-së.

Sipas Shkallës së parë, kompensimi në emër të dëmshpërblimit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës në ndërmarrje është regullur me nenin 40 të Shtojcës së ligjit për AKP-në, mbi prioritetin e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.2, ku parashehëhet se, "kërkesat për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës, të sjella nga punonjësit të cilat janë pushuar nga puna si rrjedhojë e vendimit për likudim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrje nga agjencia, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në". Shkalla e parë ka gjetur se parashtruesi i ankesës ka qenë punëtor i ndërmarrjes në momentin e fillimit të likudimit të ndërmarrjes. Andaj deri të ky konstatim Shkalla e parë kishte ardhur duke u mbështetur në provat e lëndës siç janë vërtetimi i lëshuar më datën 13 janar 2014, po ashtu edhe lista e pagave të pa kompensuara, të cilat po ashtu janë të nënshkruara nga drejtori i ndërmarrjes.

Më 11 gusht 2022, e paditura/ankuesja kishte parashtruar ankesë kundër këtij aktgjykimi duke propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar në pajtim me nenin 9.10 të Ligjit 06/L-086, duke refuzuar ankesën ndaj Vendimit të AL të AKP-së GJI135-0012 të datës 09 qershor 2016 si të pa bazuar dhe e vërtetuar këtë vendim.

E paditura thekson se kërkesa e paditësit është shqyrtuar nga Autoriteti i Likudimit dhe në fund të procesit të shqyrtimit, është konstatuar se nuk ka asnjë dëshmi që vërteton se parshtruesi kishte një marrëdhënie aktive dhe të vlefshme pune me NSH-në dhe aq më pak të ketë ofruar shërbime konkrete të punës për NSH-në, për periudhën gjatë të cilës kërkon paga. Kjo sidomos, së bashku me të dhënat e tjera të NSH-së, për shembull fakti se NSH-ja nuk ka qenë një subjektit komercial aktiv pranë ATK-së në periudhën e referuar, pra nuk gjeneronte asnjë të ardhur apo aktivitet. E paditura konsideron se parshtruesi i kërkesës ka dështuar të sjell kontratë valide për periudhën që pretendon të mos jetë paguar, librin mbi regjistrimin deklarimin e orëve të punës, dëshmitë mbi pagën mujore, të gjitha këto dëshmi që do të vërtetonin pretendimin e parshtruesit për kompensim me paga. Si rrjedhojë, AL i AKP-së vlerësoi se si e tillë kërkesa ka mbetur jo e plotë, edhe pas kërkesës për informata shtesë.

Më 12 gusht 2022, paditësi kishte parashtruar ankesë në Kolegjin e Apelit me të cilën e kundërshton aktgjykimin e Shkallës së parë, sa i përketë dëmshpërblimit mbi ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies së punës ku vërehet një mos përputhje rreth kompenzimit, kjo përkuthje lidhet me vendimin për kompenzimin e 3 (tri) pagave gjë që është në kundërshtim me ligjet në fuqi sepse për pëvojen e punës mbi 20 vite duhet të bëhet kompenzimi për 6 paga konform rregullores në fuqi. Paditësi i propozon Kolegjit të Apelit që të aprovohet kërkesa e tij sa i përketë kompenzimit të 6 pagave në bazë të listës përfundimtare

Më 19 tetor 2023, Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së e ka dërguar ankesën e paditësit tek e paditura, ndërsa ankesën e të paditurës tek paditësi për përgjigje. Në përgjigjen e tij të datës 23 tetor 2023, paditësi i kundërshton pretendimet ankimore të të paditurës si të pa bazuara, duke ofruar edhe njëherë dëshmitë dhe provat që tashmë gjenden në shkresat e lëndës, në mbështetje të pretendimeve të tij në kërkesën/ankesë që po shqyrtohet.

E paditura në përgjigjen e saj të datës 17 nëntor 2023, thekson se pala paditëse nuk ka arritur që të ofrojë asnjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij, andaj ankesa duhet të refuzohet, derisa në anën tjetër duhet të aprovohet ankesa e AKP-së dhe të anulohet aktgjykimi i ankimuar apo i njëjti të ndryshohet.

## **Arsyetimi ligjor**

-Ankesa e paditësit është e bazuar.

-Ankesa e të paditurës është e pa bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të ligjit nr.06/L086 mbi Dhomën e Posqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për qështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Shkalla e parë e e kishte aprovuar sit ë bazuar ankesën e paditësit, e kishte ndryshuar vendimin e kundërshtuar të AL të AKP-së, duke ia njohur paditësit të drejtën për kompensim për paga të pa paguara për periudhën qershor 2012, e deri në muajin dhjetor 2013, t'i paguajë shumën prej 3.287.00, po ashtu dëmshpërblimin për shkak të ndërprerjes oara kohe të marrëdhënies së punës paditësit t'ia kompensojë 3 paga nga 173.00 euro, në shumën prej 519.00 euro, brenda afatit prej 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi dhe detyrohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës (takes për ankesë), pales paditëse t'ia komesojë shumën e mjeteve në lartësinë prej 20.00 euro brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e pranimit.

Paditësi e kundërshton aktgjykimin e Shkallës së parë, sa i përketë dëmshpërblimit mbi ndërprerjen e parakohshme të marrëdhënies, gjegjësisht kompensimin e 3 (tri) pagave dhe konsideron se bazuar në pëvojen e punës mbi 20 vite, duhet të bëhet kompenzimi për 6 paga konform ligjit në fuqi.

E paditura nuk pajtohet me konstatimin e Shkallës së parë të DHPGJSK-së dhe thekson se nuk ka asnjë dëshmi që vërteton se parashtruesi kishte një marrëdhënie aktive dhe të vlefshme pune me NSH-në dhe aq më pak të ketë ofruar shërbime konkrete të punës për NSH-në për periudhën gjatë të cilës kërkon paga. E paditura konsideron se parashtruesi i kërkesës ka dështuar të sjellë kontratën valide për periudhën që pretendon të mos jetë paguar, librin mbi regjistrimin deklarimin e orëve të punës, dëshmitë mbi pagën mujore, të gjitha këto që do të vërtetonin pretendimin e parshtruesit për kompensim me paga. Si rrjedhojë, si e tillë kërkesa ka mbetur jo e plotë edhe pas kërkesës për informata shtesë

Kolegji i Apelit pasi që ka shqyrtuar pretendimet ankimore të paditësit dhe të të paditurës, aktgjykimin e ankimuar dhe shkresat e landës ka gjetur se ankesat janë të pa bazuara, ndërsa aktgjykimi i ankimuar është i saktë në rezultat dhe në arsyetim ligjor.

Kolegji i Apelit e aprovon ankesën e paditëit si të bazuar duke e ndryshuar aktgjykimin e ankimuar sa i përket komepnsimit në bazë të stazhit të punës. Në bazë të dëshmisë së parashtruar nga paditësi, "Lista përfundimtare e punëtorëve", e lëshuar nga AKP, dëshmohet se J R ka stazh pune në NSH 24.19 vjet. Në bazë të nenit 76, paragrafi 7, pika 4 i Ligjit të Punës 03/L-212 paditësit i takon kompensimi për 6 paga mujore në këtë NSH. Për 6 paga mujore nga 173,00 euro duhet të kompensohet në shumën prej 1.038,00 euro.

Kolegji i Apelit nuk pajtohet me pretendimet e të paditurës e cila pohon se nuk ka asnjë dëshmi që vërteton se parshtruesi kishte një marrëdhënie aktive dhe të vlefshme pune me NSH-në dhe aq më pak se ka ofruar shërbime konkrete të punës për NSH-në për periudhën gjatë të cilës kërkon paga. Kjo për faktin se dëshmitë e ofruara nga paditësi dëshmojnë të kundërtën e asja çka deklaroi e paditura. Vërtetimi i datës 13 janr 2014 i nënshkruar nga drejtori i NSH-së dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e pa paguara për periudhën kohore 06 qershor 2012 deri në dhjetor 2013 për 19 muaj nga 173 euro. Se paditësi ishte në marrëdhënie pune në NSH në këtë periudhë, dëshmohet edhe me Vendimin për pushim pa pagesë të datës 03 janar 20147, e po ashtu edhe me listat e pagave të pa paguara për periudhën kontestuese, të cilat po ashtu janë të nënshkruara nga drejtori i ndërmarrjes.

Për këto arsye si më lartë, ankesat e paditësit dhe të paditurës refuzohen si të pa bazuara dhe rrjedhimisht vërtetohet aktgjykimi i ankimuar si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Nga ajo që u tha më sipër, u vendos sin ë dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **Taksa gjyqësore**

AKP për ankesën e saj tashmë e ka paguar taksën gjyqësore për procedurën ankimore para Kolegjit të Apelit, andaj nuk do të caktohen taksa shtesë.

Lëshuar nga Kolegji i Apelit të DHPGJSK-së më 07 dhjetor 2023.

**Mr.Sc Sahit Sylejmani gjyqtar kryesues** \_\_\_\_\_